Konfirmuar
Evelina Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE,ZHVILLIMIT RURAL DHE URBAN
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Nr.1886 Prot

Lushnje, më 19 / 02 /2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE Z.JUGERT ÇEMERI BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI. LAGJA "LONI DHAMO"/ NJ.A.NR.3.

Z.Jugert Çemeri është banor i lagjes "Loni Dhamo", Njësia Administrative Nr.3, Bashkia Lushnje, ka paraqitur kërkesën me Nr. Prot.1057 datë.27/01/2026 për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e tij nga rënia e zjarrit dhe ka kërkuar ndihmë për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit janë ngritur komisionet me urdhërat përkatës :

1. Urdhëri për ngritjen e komisionit të konstatimit të dëmeve të shkaktuara në banesë Nr.40 Prot. datë. 02/02/2026, i përbërë nga:
   a. Avni Begolli — Kryetar
   b. Agron Hajdari — Anëtar
   c. Artur Sinani — Anëtar

2. Urdhëri për ngritjen e komisionit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesë me Nr.41 Prot. datë. 02/02/2026 i përbërë nga:
   a. Elton Koroveshi — Kryetar
   b. Flavia Korreshi — Anëtare
   c. Xhoana Ikonomi — Anëtare

Komisjoni pasi bëri verifiminin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e Z.Jugert Çemeri, referuar kërkesës së tij, është hartuar preventivi me zërat e orendive të dëmtuara. Në bazë të V.K.M. Nr:329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurave e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuar nga veprimtari njerëzore, të dëmtuarit i jepet ndihmë financiare 50% e vlerës. Bazuar në preventivin e hartuar vlera e

dëmit të shkaktuar në banesën e Z.Jugert Çemeri është përllogaritur në vlerën 727 963 (shtatëqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë. Në këto kushte propozojmë këshillit të bashkisë të miratojë një ndihmë financiare në vlerën 363 981.5 (treqindë e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqindë e tetëdhjetë e një pikë pesë) lekë.
Referuar dhe vërtetimit për rënie zjarri me Nr.03 Prot. datë 28/01/2026 lëshuar nga MZSH Lushnje që vërteton rënien e zjarrit në banesë.

Faleminderit për mirëkuptimin!

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
ELTON KOROVESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr. 1886/1 Prot.

Lushnje,më 19/02/2026

PROJEKT – VENDIM

NR. 22 DATË 19/02/2026

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE Z.JUGERT ÇEMERI PËR REHABILITIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË, LAGJA "LONI DHAMO"/N.J.A.NR.3.

KËSHILLIT TË BASHKISË LUSHNJE

Në mbledhjen e datës ___/___/2026 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga zyra e Emergjencave Civile dhe në bazë të Ligjit Nr.139/2015 datë 17/12/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 3, shkronja "e" , neni 40, pika 1, VKM Nr. 414 datë 08/07/2021, pika 3.1, shkronja "a", pika 5, pika 6, Ligjit Nr.45/2019 "Për Emergjencat Civile", Neni 7, Neni 30 germa " gj", VKM Nr. 329 datë 16/05/2012, Paragrafi III, gërma "e" , gërma "ë" dhe "f", "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" sipas kërkesës së Z.Jugert Çemeri me Nr.1057 Prot. datë.27/01/2026.

PROPOZOJ :

1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lushnje për mbështetje financiare të shtetasit **Z.Jugert Çemeri** për dëmtimin e banesës së tij.

2-T'i akordojë familjes së shtetasit Z.Jugert Çemeri ndihmën financiare, emergjente në vlerën prej, **363 981.5 (treqindë e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqindë e tetëdhjetë e një pikë pesë) lekë** nga fondi i Emergjencave - Civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2026.

3-Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve dhe e Financës.

4- Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
ELTON KOROVESHI

DREJTORI JURIDIK
BEDRI HIDA

KRYETARE
ERISELDA SEFA